



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 12.12.2018

Lënda: Relacion për shtesa e ndryshime në ligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”

Drejtuar:

Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Z. Gramoz RUÇI

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 81, pika 1 të saj, në cilësinë e subjektit kushtetues për të ndërmarrë nismë legjislative, ne një grup deputetësh propozojmë këtë projektligj. Arsyet e ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore janë të shprehura në këtë relacion që shoqëron projektligjin.

Propozojmë në ligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e paraqitura.

Prej 8 ditësh tashmë, studentë nga e gjithë Shqipëria kanë protestuar dhe vazhdojnë të protestojnë për të rritur cilësinë e Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe mbi të gjitha për të ulur tarifat e Universiteteve dhe për të përmirësuar infrastrukturën universitare dhe atë të konvikteve të studentëve e cila gjendet në kushte të mjerueshme.

Ne propozojmë që në Buxhetin e vitit 2019 të dyfishohen zërat për Arsimin Universitar dhe Kërkimin Shkencor, duke e cuar atë në total rreth 1% të PBB, me vlerë 14.909.916.000 Lek për Arsimin Universitar dhe 124.000.000 Lek për Kërkimin Shkencor me qëllim përgjysmimin e tarifave deri në zerimin e tyre, pajisjen e studentëve me Kartën e Studentit, ngritjen e Bibliotekës Online dhe përditësimi me tekste online, mbështetja me buxhet i Kërkimit Shkencor, etj si masa minimale për të filluar zgjidhjen e situatës kritike në të cilën ndodhet arsimi i lartë në Shqipëri.

Krijimi i fondit të Emergjencës në Arsimin e Lartë është përgjigja e vetme e menjëhershme ndaj situatës skandaloze, në të cilën jetojnë nga 14 mijë deri në 17 mijë studentë çdo vit akademik.

Ky fond do të ishte përgjigje e vërtetë dhe konkrete për situatën, ndryshe nga qëndrimet e deritanishme ku qeveria ka premtuar financime dhe ndryshime pa bërë asnjë hap konkret.

Fondi i Emergjencës do të orientohet drejt rikonstruksioni të konvikteve, ndërtimin e kapaciteteve të reja të cilat do të ndryshonin dhe do të krijonin kushtet bazike, të cilat fatkeqësisht sot 28 vite pas rënies së regjimit komunist mungojnë krejtësisht, duke krijuar në këtë mënyrë mundësitë për një jetesë normale të studentëve gjatë viteve të tyre të studimit.

Deputetët Propozues:

- 1) Idrizi Uchuckaj
- 2) Floida Kërpaçi